



## KONFERENCË SHTYPI MË 17 NËNTOR 2000.

### I. ZHVILLIMET NË POLITIKËN MONETARE, OPERACIONET MONETARE, TREGUN E KAPITALEVE DHE TREGUN VALUTOR

#### 1. Si paraqiten zhvillimet makroekonomike dhe cilat janë perspektivat e afërta?

Të dhënat e raportuara për aspekte të ndryshme të ekonomisë flasin, në tërësi, për disa përmirësime të ekonomisë shqiptare në vitin 2000. Kjo është pasqyruar edhe në rishikimin e treguesve kryesorë makroekonomikë që u bënë në tetor të këtij viti. Në bazë të të dhënave të disponueshme vërehen përmirësime në disa sektorë të ekonomisë.

Vërehet një përmirësim në sektorin publik të industrisë. Indeksi i prodhimit industrial në volum, në fund të muajit shtator (me bazë vitin 1993) u ngjit në 85.8 për qind nga 68 dhe 58.3 për qind të regjistruar përkatësisht në tremujorin e dytë dhe të parë. Kjo rritje ishte kryesisht kontribut i industrisë metalurgjike dhe përpunimit të metaleve dhe nxjerrjes së produkteve energjitike. Duket se procesi i ristrukturimit po fillon të gjenerojë efektet pozitive të pritshme.

Aktiviteti tregtar i realizuar në rreth 829 milionë dollarë amerikanë, deri në fund të muajit gusht, vlerësohet më i lartë krahasuar me vitin paraardhës (4.1 për qind). Rritja në importe (rreth 7.7 për qind) përfaqëson shkakun e vetëm në rritjen e shkëmbimeve tregtare me botën, ndërkohë që, eksporti mbetet nën nivelin e realizimeve të vitit paraardhës (7.9 për qind më i ulët). Zhvillimet në sektorin e jashtëm, po t'i referohemi statistikave për gjashtë muajt e parë të vitit, duken se janë nën kontroll dhe reflektojnë ecurinë e ekonomisë së brendshme.

Krahasuar me një vit më parë, shpenzimet korente janë rritur me rreth 34 për qind ndërkohë që të ardhurat paraqiten 5 për qind më të ulëta. Megjithatë, deficiti korent duket se është në përputhje me parashikimet e bëra në program dhe pritet të jetë i tillë deri në fund të vitit. Dërgesat nga emigrantët deri në fund të gjashtëmujorit të parë vlerësohen 280 milionë dollarë amerikanë.

Duke u bazuar edhe në "tradi tën" që këto dërgesa rriten në gjashtëmujorin e dytë të vitit, krahasuar me të parin, vlerësohet që dërgesat të tejkalojnë parashikimet e bëra në fillim të vitit prej 450 milionë dollarë amerikanë duke zëvendësuar kështu rritjen e deficitit tregtar.

Tendenca pozitive duken në fushën e investimeve. Kështu, importet e makineri e pajisjeve, gjatë tetë muajve të parë të vitit, arritën në 77.7 milionë dollarë, nga 66.9 milionë që ishin gjatë tetë muajve të parë të vitit të kaluar ose me një rritje prej 16 për qind.

Situata bujqësore e këtij viti vlerësohet të jetë më e mira në këta 10 vjetët e fundit. Sipërfaqja e mbjellë (nën kulturë) është më e larta e vërejtur deri tani. Kjo reflektohet në praninë e një sasive më të madhe të prodhimit vendas në treg, me cilësi më të lartë dhe çmime më të ulëta.

Bilanci i eksport-importit për produktet ushqimore (në vlerë) për gjashtëmujorin e parë të këtij viti në krahasim me një vit më parë është përmirësuar ndjeshëm me rreth 23 milionë dollarë. Eksportet bujqësore janë rritur me 10 për qind ndërsa importet bujqësore janë ulur me 18 për qind.

Inflacioni në fund të muajit tetor të vitit 2000, arriti nivel vjetor pozitiv prej 1.7 për qind. Papunësia është reduktuar më tej duke arritur në muajin shtator 2000 në 219 170 vetë.

Nëse nuk mund të deklarohet norma e papunësisë, pasi ende nuk është publikuar shifra për forcën punës për të njëjtën periudhë (në fund të muajit qershor ajo ishte 17.1 për qind), mjafton të përmendet që niveli i të papunëve në fund të muajit gusht arrin në 223 mijë. Pra, brenda një muaji kemi reduktim të numrit të të papunëve me 4 mijë vetë.

## **2. Cila është ecuria e inflacionit dhe pritshmëria deri në fund të vitit 2000?**

Është e nevojshme të theksoj edhe një herë objektivin themelor të Bankës së Shqipërisë, që është "**arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve**". Me stabilitet të çmimeve kuptohet një nivel inflacioni i ulët por pozitiv, përgjithësisht në kufijtë e 2-4 për qind, që përbën edhe objektivin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2000. Deri në fund të muajit tetor 2000, inflacioni vjetor ka arritur në 1.7 për qind dhe Banka e Shqipërisë synon, që deri në fund të vitit, të arrihet kufiri i poshtëm i objektivit prej 2-4 për qind.



Faktorët më kryesorë që vlerësohet se kanë ndikuar në mbajtjen e një niveli të ulët dhe stabël çmimesh për vitin 2000 janë:

- \* Respektimi i programit përpara i përket aspekteve fiskale dhe monetare, i cili matet me respektimin e objektivave sasiorë monetarë dhe fiskalë. Përpara i përket aspekteve monetare vërehet që në fund të muajit tetor, rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë ishin 359 milionë dollarë amerikanë ose 80.8 milionë më shumë se sa objektivi i poshtëm. Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë ishin 80.5 miliardë lekë ose 2.3 miliardë nën objektivin e sipërm. Kredia neto e sistemit bankar për qeverinë, në fund të muajit shtator, ishte 210.8 miliardë lekë ose 10.4 miliardë poshtë objektivit të sipërm. Paraja gjithsej, deri në fund të muajit shtator është rritur me 18.85 miliardë lekë. Sipas programit monetar duhet që deri në fund të vitit të rritet me 16.47 miliardë lekë.

Kontributin kryesor në rritjen e parasë gjithsej e ka dhënë paraja jashtë bankave me një rritje prej 10.61 miliardësh ndërsa depozitat në total, ndryshe nga periudhat e mëparshme kanë patur ritme më të ulta rritjeje. Për t'u theksuar janë rritja e raportit para jashtë bankave/para gjithsej në nivelin 29.5 për qind nga 27.8 për qind në fund të vitit të kaluar dhe rritja e raportit depozita në valutë/depozita në lekë nga 33.6 për qind në 40.22 për qind.

(Këtu ndikon edhe kursi i këmbimit të dollarit me lekun.) Raporti i parë tregon për një rritje aktuale të kërkesës për para në ekonomi e cila ka tendencë të vazhdojë edhe në të ardhmen. Kjo do të thotë se presionet inflacioniste do të jenë më të mëdha se në periudhat e mëparshme. Nga ana tjetër, financimi i brendshëm deri në fund të shtatorit kap shifrën 15.89 miliardë lekë nga 23.65 miliardë deri në fund të vitit.

Kjo periudhë është karakterizuar edhe nga reduktime të evazionit fiskal dhe rritje të të ardhurave buxhetore si pasojë e përmirësimit të punës në drejtim të mbledhjes së taksave dhe tatimeve ndërkohë që ky proces nuk është shoqëruar me rritjen e normës së taksave dhe madje ulje të tarifave doganore.

Është për t'u theksuar rritja e shpenzimeve për investime kapitale apo për investime publike. Ky faktor, përgjithësisht, ndihmon në rritjen e presioneve inflacioniste duke zgjeruar në të njëjtën kohë hapësirën për rritje ekonomike në një periudhë afatmesme.

- \* Rritja e PBB-së më shumë se sa ishte parashikuar. Sidomos ka kontribuar rritja e prodhimit bujqësor. Kjo bëri që të zëvendësoheshin mallrat e importit me produkte të prodhuara në vend, të cilat dalin në treg me çmim më të ulët. Për të konfirmuar këtë mjafton t'u referohemi niveleve të çmimeve të muajve maj, qershor dhe korrik (shih tabelën 1).

**Tabela 1: Seritë mujore të normës së inflacionit.**

Muajt	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Janar	2.02	1.75	2.04	1.62	3.46	0.91	0.63
Shkurt	1.70	2.31	1.73	5.32	1.81	-0.61	-0.6
Mars	0.63	0.31	1.56	14.05	1.16	-0.29	-1.11
Prill	9.00	1.67	1.45	-1.53	1.61	0.01	0.72
Maj	1.72	-0.47	1.04	1.04	-0.19	-0.64	0.67
Qershor	1.66	-1.82	-0.75	5.42	-1.74	-2.28	-2.1
Korrik	-3.34	-3.30	2.52	-1.21	-2.01	-1.30	-2.7
Gusht	-2.06	0.82	2.36	0.61	0.41	-0.28	0.39
Shtator	0.13	1.07	2.45	1.61	1.45	0.10	1.7
Tetor	1.00	0.67	1.61	5.04	0.26	0.39	1.3
Nëntor	0.87	2.32	-0.47	2.28	0.21	0.78	
Dhjetor	1.90	0.69	0.67	2.29	2.05	2.25	

- Niveli i ulët i inflacionit të importuar. Siç dihet 78 për qind e importeve shqiptare janë nga vendet e Komunitetit European, kryesisht Italia dhe Greqia, të cilat karakterizohen për stabilitet çmimesh. Për më tepër, karakteristikë e kësaj periudhe ka qenë zhvlerësimi i euros kundrejt dollarit. Duke pasqyruar lëvizjet e tregut ndërkombëtar, edhe monedha shqiptare është mbiçmuar në raport me monedhat europiane dhe është nënçmuar në raport me dollarin amerikan. Kjo është pasqyruar në importe më të lira duke ndikuar në uljen e nivelit të çmimeve në tregun e vendit.
- Ambjenti politik ka qenë relativisht i stabilizuar duke shërbyer si një pikë mbështetjeje për zhvillime inflacioniste të kontrolluara dhe në nivele të ulta.

Për vitin e ardhshëm, sidomos në gjashtëmuajorin e parë, vlerësohet që të rriten presionet inflacioniste duke u bazuar në:



\* ecurinë e çmimeve të konsumit për tre vitet e fundit, por duke u përqendruar më tepër në vitet 1999-2000 (shih tabelën 2);

**Tabela 2: Seritë vjetore të normës së inflacionit.**

Muajt	1998	1999	2000
Janar	37.3	6.0	-1.3
Shkurt	22.6	3.5	-1.3
Mars	24.0	2.0	-2.1
Prill	28.0	0.4	-1.4
Maj	26.4	-0.1	-0.1
Qershor	17.8	-0.6	0.1
Korrik	16.9	0.1	-1.3
Gusht	16.7	-0.6	-0.7
Shtator	16.5	-1.9	0.9
Tetor	11.2	-1.8	1.7
Nëntor	8.9	-1.2	
Dhjetor	8.7	-1.0	

- supozimin që në fund të vitit 2000 norma vjetore e inflacionit do të jetë rreth 2 për qind;
- supozimin që viti 2001 do të shënojë kthesë në ecurinë e vlerës së euros me drejtim vlerësimit e saj;
- krizën energjitike, që përfshiu vendin si në rritje të çmimeve të karburanteve, ashtu edhe në kufizimet me furnizim të energjisë elektrike. Kjo krijon premisa për rritjen edhe të nivelit të inflacionit të importuar. Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar u pasqyrua disi qysh në muajin tetor të këtij viti. Çmimet e komponenteve “lëndë djegëse dhe energji” dhe “transport” për muajin tetor u rritën përkatësisht 3.6 dhe 1.7 për qind;
- transmetimin e vendimeve të politikës monetare, të cilat kanë synuar zbutjen nëpërmjet reduktimit të normës së interesave;
- deklarin për rritje pagash dhe mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme elektorale, situata të cilat, përveç efekteve psikologjike, potencialisht krijojnë shmangie ose më e pakta vështirësojnë administrimin e problemeve.

Më konkretisht, dua të ndalem në krizën energjitike. Me shportën aktuale pesha e karburanteve dhe e energjisë elektrike nuk është e konsiderueshme dhe rritjet në çmimin e energjisë nuk konvertohen drejtpërdrejt në rritje të inflacionit. Por, duhet të kemi parasysh efektin zinxhir, që jep rritja e çmimit të energjisë në rritjen e kostos së transportit apo të prodhimit gjë që në një kohë të mëvonshme konvertohet në produkte, që në treg dalin me çmime më të larta.

Prandaj, kriza që filloi në muajin tetor efektet e saj i jep me disa muaj vonesë. Se sa do të jetë realisht ndikimi kjo ende nuk është e mundur të përcaktohet pasi: së pari, ende nuk është matur ndikimi i deritanishëm i kësaj krize, kjo do të qartësohet në rezultatet që do të merren për muajt nëntor dhe dhjetor; dhe, së dyti, nuk është e qartë se për sa kohë do të zgjasë kriza energjetike, a do të ketë përkeqësim apo përmirësim.

Megjithatë, dëshiroj të theksoj edhe një herë se, duke u mbështetur nga ecuria e inflacionit për vitet 1999 dhe 2000, si edhe duke marrë shkas nga kriza aktuale energjetike, vlerësojmë se objektivat deri në fund të vitit 2000 do të realizohen dhe se, edhe për vitin e ardhshëm do të ruhet i njëjti objektiv inflacioni që do të thotë ndërmjet shifrave 2 dhe 4 për qind. Në këtë mënyrë, Banka e Shqipërisë ka arritur që për të tretin vit rradhazi të arrijë objektivin e shpallur të inflacionit, të ndjekë me sukses të gjithë treguesit e shpallur në programin ESAF.

### **3. Cili është elementi i ri në politikën monetare dhe, konkretisht, në atë të normave të interesit, gjatë këtij viti?**

Për zbatimin e politikës së saj Banka e Shqipërisë, aktualisht, operon vetëm me instrumente indirekte të kontrollit monetar dhe konkretisht: ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve, rezervën e detyrueshme, kredinë e rifinancimit dhe kredinë lombard.

Ajo ka filluar të operojë tërësisht me instrumentet indirekte të saj që në muajin shtator kur u hoq dorë plotësisht nga kontrolli monetar direkt, që realizohej me anë të normës minimale të interesit për depozitat me afat në lekë.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë e mbështet zbatimin e politikës monetare në përdorimin e instrumenteve indirekte dhe konkretisht, ka si instrument në dispozicion ankandet javore të repove, në të cilat ajo përcakton edhe përqindjen nominale të interesit.

Pra, elementi i ri në politikën e normave të interesit është shkëputja me sukses nga instrumentet direkte të kontrollit monetar dhe kalimi në përdorimin e instrumenteve indirekte, që i hapin rrugë zhvillimit të tregut.

Kjo erdhi si pasojë e zhvillimeve të këtij viti në normat e interesit të depozitave. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2000, niveli dysHEME i interesave të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për bankat me kapital tërësisht shtetëror, vazhdoi të mbetet instrumenti kryesor në transmetimin e vendimeve të politikës monetare.



Nga ecuria e treguesve më të rëndësishëm makroekonomikë dhe financiarë në vend, si dhe ndikimi që ata japin në arritjen e treguesve sasiore, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2000, Banka e Shqipërisë ndryshoi katër herë nivelin minimal të normave të interesit për depozitat në lekë.

Por, uljet e njëpasnjëshme të nivelit minimal të interesave, nga ana e Bankës së Shqipërisë nuk gjetën reflektimin e duhur në interesat e tregut. Kjo tregoi që niveli i interesave për depozitat me afat në lekë, i konsideruar si "normë reference e tregut" nuk i përgjigjej realitetit në drejtim të lëvizjes së normave të tjera në tregun bankar.

Një sjellje e tillë tërhoqi vëmendjen e Bankës së Shqipërisë për të nxituar në rrugën drejt kalimit nga rregullimet administrative të normave të interesit për depozitat në lekë, në përdorimin e instrumenteve indirekte të politikës monetare. Për këtë arsye, paralelisht me hapat e kujdesshëm, që u ndërmoren për të kaluar plotësisht në mbështjetjen tek instrumentet indirekte, u veprua shumë shpejt me liberalizimin e normave të interesit për depozitat në lekë.

Paralelisht me këto zhvillime, brenda periudhës maj - shtator u liberalizuan, njëri pas tjetrit interesat për depozitat me afat në lekë. Ky proces nisi fillimisht me liberalizimin e nivelit të interesave për depozitat me afat maturimi gjashtëmujor. Në përputhje me zhvillimet e tregut, fillimin e funksionimit të ankandeve të repove, Banka e Shqipërisë, në korrik, kreu edhe liberalizimin e nivelit minimal të interesit për depozitat me afat dymbëdhjetëmujor dhe në shtator, liberalizimin e interesit minimal për depozitat me afat tremujor.

Nga ana tjetër, brenda kësaj periudhe, u përfundua privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare, duke sjellë edhe ndryshime të rëndësishme në pjesët e tregut midis bankave sipas kapitalit; Banka e Shqipërisë filloi zbatimin e ankandeve javore të repove; si dhe u konsoliduan eksperiencat e mëparshme të përdorimit të instrumenteve afatshkurtra në lëvizjet e tregut etj..

Sipas karakteristikave dhe shkallës së zhvillimit të sistemeve financiare në vende të ndryshme, dhe instrumentet që zgjidhen nga bankat qendrore përkatëse për të transmetuar sinjale të politikës monetare janë të ndryshme. Kështu, në disa vende si sinjalizues përdoret instrumenti i rifinancimit e në disa të tjera ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve (ECB).

Meqenëse tregjet financiare në Shqipëri janë ende të pazhvilluara mirë dhe sistemi bankar shqiptar është karakterizuar për një periudhë më shumë se dyvjeçare nga tepricë likuiditeti, Banka e Shqipërisë ka zgjedhur si optimale të operojë në treg me anë të instrumentit “Ankande të marrëveshjeve të riblerjeve”.

Ky instrument është bërë i njohur për sistemin bankar që në muajin korrik. Me anë të tij Banka e Shqipërisë influencon në nivelin e rezervave të tepërta për periudha kohe të shkurtra, deri në një javë.

Përdorimi i instrumentit të “Ankandëve të marrëveshjeve të riblerjeve”, ofron një sërë përparësish:

- \* një rang i gjerë i tipeve të ankandëve, maturiteteve etj., i jep Bankës së Shqipërisë një hapësirë të gjerë për të manovruar në treg;
- \* me anë të ankandit, fondet kalojnë në treg në mënyrë elastike, duke i dhënë mundësi Bankës së Shqipërisë të reagojë shpejt dhe me eficiencë ndaj luhatjeve të likuiditetit nëpërmjet përcaktimit të tipit të ankandit;
- \* publikimi i ofertave dhe i rezultateve të ankandëve garanton një shkallë të lartë transparence për gjithë tregun;
- \* meqë të gjitha bankat përballojnë pothuajse probleme të njëjta teknike, kryerja e ankandëve përfaqëson një instrument të drejtë e të paanshëm në plotësimin e mungesave të likuiditetit.

Muajt e fundit vihet re rënie e *yield*-it të bonove të thesarit, sidomos atyre tremujore. Nisur nga ky fakt, mendojmë se kjo është premisë e mirë dhe për normat e tjera të tregut të parasë, dhe konkretisht të kreditit për ekonominë, pasi, siç dihet, norma e interesit të tregut të bonove të thesarit shërben si normë reference për normat tjera të interesit. Gjithashtu, tendenca rënëse e kësaj norme do të ketë efektin e saj në nxitjen e bankave për bërjen e një politike krediti më agresive në tregun e huadhënies në lekë.

Megjithëse niveli i kredisë së dhënë është rritur, kostoja e saj nuk ka ndryshuar dukshëm. Ndoshta kjo për vetë mënyrën e përcaktimit të normës së interesit të kredive në lekë, ku vlerësohet risku i kthimit të kredive dhe risku i vendit.

Reforma strukturore e sistemit bankar (përfundimi i procesit të privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare dhe fillimi i këtij procesi për Bankën e Kursimeve), reforma institucionale, që ka përfshirë gjithë institucionet





publike, stabiliteti i gjendjes ekonomike e financiare të vendit, politikat nxitëse për rritje ekonomike, natyrisht, do të kenë efektet e tyre për vlerësimin e riskut të vendit. Mendojmë, se efekti i tyre do të ndihet në ekonominë shqiptare në periudhat në vijim.

Banka e Shqipërisë, në funksion të zhvillimeve financiare dhe të sjelljes së lojtarëve në tregun monetar ka filluar një proces reformimi të të gjitha instrumenteve në dispozicion, që do të sjellin rritjen e fleksibilitetit në ndërhyrjet e saj për arritjen e objektivave sasiore dhe të atij final, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

#### **4. Si funksionon përdorimi i instrumenteve indirekte të politikës monetare në tregun monetar shqiptar?**

Experienca botërore tregon se përdorimi me efektivitet i instrumenteve indirekte të politikës monetare si dhe në të njëjtën kohë realizimi me sukses i qëllimit të përdorimit të tyre, kërkon një situatë të përgjithshme makroekonomike të qëndrueshme si dhe një politikë fiskale të shëndetshme.

Përveç këtyre kushteve, që lidhen me sektorin real, është e rëndësishme që të punohet dhe në drejtim të zhvillimit të një sistemi financiar të shëndoshë e konkurrues si edhe të plotësimit të një kuadri rregullator bashkëkohor nga ana e supervizionit.

Banka e Shqipërisë, tashmë, operon vetëm me instrumente indirekte dhe arriti ta realizojë këtë objektiv që në shtator, pra më shpejt nga objektivi i përcaktuar që ishte fundi i vitit 2000. Në këtë pikëpamje ajo mund të konsiderohet si të gjitha bankat e tjera qendrore në vendet me sisteme më të përparuara financiare.

Banka e Shqipërisë e nisi rrugën e përdorimit të instrumenteve indirekte për zbatimin e politikës monetare në kushtet:

- \* e një stabiliteti të përgjithshëm makroekonomik;
- \* e një situatë fiskale të shëndoshë;
- \* e një supervizioni të aftë për të kryer punën e tij (këtu kihet parasysh edhe kuadri rregullativ sipas standardeve ndërkombëtare);
- \* e pamundësisë së zbatimit të politikës monetare nëpërmjet instrumenteve direkte;
- \* e një sistemi financiar jo fort konkurrues,
- \* e mungesës së një tregu të zhvilluar të parasë;

- \* e mungesës së eksperiencës së plotë në drejtim të zgjedhjes, të formulimit e të përdorimit të instrumenteve indirekte.

Në hapat e parë e në vazhdim të zbatimit të këtij procesi, Banka e Shqipërisë ka kërkuar gjithmonë mirëkuptimin dhe ndihmën e Ministrisë së Financave e të bankave të nivelit të dytë, reagimi i të cilave ka qenë i ndryshëm.

Gjithashtu, ishte e domosdoshme që vetë Banka e Shqipërisë të rishihte qëndrimin e saj ndaj bankave të nivelit të dytë duke u kthyer nga pasive në aktive.

Në këtë mënyrë, Banka e Shqipërisë do të kishte mundësinë t'iu thoshte edhe "jo" kërkesave për veprime të bankave të nivelit të dytë duke patur si qëllim kryesor zbatimin e politikës monetare.

Ky ndryshim sjelljeje i Bankës së Shqipërisë pritet që të sjellë frutet e veta pozitive edhe në drejtim të zhvillimit të tregut ndërbankar e të rritjes së rolit ndërmjetësues të bankave të nivelit të dytë.

Që në fillim të këtij procesi, nga ana e Bankës së Shqipërisë, u përcaktuan objektivat operacionalë, që duhej të arriheshin, si dhe mjetet në dispozicion të saj për arritjen e këtyre objektiveve. Më konkretisht u përcaktuan:

- A. Si objektiva operacionalë: Normat e interesit për bonot e thesarit tremujore (primare) si dhe niveli i rezervave të tepërta në sistem.
- B. Si instrumente në dispozicion: Ankandet javore repo.

#### **A. OBJEKTIVAT OPERACIONALË.**

##### **a. Norma e interesit për bonot e thesarit tremujore.**

Që në fillim, duhet thënë se Banka e Shqipërisë ka qenë e suksesshme në drejtim të influencimit të uljes së normave të interesit për bonot e thesarit tremujore për 285 "basis points"(b.p.) (në datën 6 korrik norma e interesit për bonot e thesarit tremujore ka qenë 10.6691 për qind, ndërsa në datën 14 nëntor është 7.82 për qind).

Norma e interesit për bonot e thesarit tremujore, gjatë vitit 2000, është karakterizuar vazhdimisht vetëm nga tendenca rënëse. Ndërsa, gjatë gjashtëmujorit të parë janë përdorur instrumentet direkte (janë ulur 3



herë nga 9.25 për qind në 6.50 për qind) për të influencuar normën e interesit, gjatë tremujorit të tretë e në vazhdim janë përdorur instrumentet indirekte për të arritur të njëjtin qëllim.

Tashmë Banka e Shqipërisë testoi si më të suksesshëm përdorimin e instrumenteve indirekte se sa të atyre direkte dhe vazhdon ndjekjen për përsosjen e mëtejshme të parave. Konkretisht, gjatë kohës së përdorimit të instrumenteve indirekte norma e interesit për çdo ditë është ulur me 0.25 për qind ose me 2.71 b.p nga 0.15 për qind dhe 2.30 b.p që ishte ulja gjatë përdorimit të instrumenteve direkte.

Megjithatë, influencimi i normave tremujore të bonove të thesarit nuk ka qenë qëllim në vetvete por, nëpërmjet tyre, Banka e Shqipërisë ka synuar të influencojë dhe nivelin e interesave, që bankat paguajnë për depozitat. Edhe në këtë drejtim lëvizja ka qenë pozitive. Kjo lëvizje tregon se bankat kanë filluar të ndjejnë konkurrencën në treg dhe se niveli i normave të interesit është pothuajse në fund të ciklit.

Nga politika monetare, që ka ndjekur Banka e Shqipërisë në këtë drejtim, janë influencuar edhe normat e interesit për bonot e thesarit për periudhën gjashtë dhe dymbëdhjetë mujore, por ritmi i uljes së tyre ka qenë më i vogël. Gjithashtu, bankat e nivelit të dytë kanë reaguuar edhe në drejtim të uljes së interesit që ato paguajnë për depozitat me afate gjashtë dhe dymbëdhjetë mujore.

#### **b. Niveli i rezervave të tepërta në sistem.**

Banka e Shqipërisë e nisi procesin e zbatimit të instrumenteve indirekte kur në sistemin bankar nuk ishin më shumë se 1 miliard lekë rezerva të tepërta.

Një nivel i tillë rezerve nuk i jepte asaj mundësinë praktike që të fillonte të përdorte instrumentet indirekte e jo më të mendonte që të influenconte nivelin e normave të interesit.

Kështu, detyra primare e bankës ishte që të rriste nivelin e rezervave të tepërta në sistem. Për këtë ju kërkua mirëkuptimi e bashkëpunimi bankave të nivelit të dytë reagimi i të cilave ishte pasiv. Duke marrë në konsideratë reagimin e bankave, i vetmi partner që mbeti, ishte Ministria e Financave, e cila u tregua e gatshme për të bashkëpunuar.

Ky bashkëpunim u materializua me organizmin e mbledhjeve javore midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, objekti kryesor i të cilave ishte parashikimi i deficitit buxhetor për një periudhë kohore dyjavore si dhe gjetja e mënyrave për financimin e tij.

Në të njëjtën kohë, Banka filloi punën për të përcaktuar faktorët kryesorë, që ndikonin rezervat e tepërta, të cilët i përdori më vonë gjatë procesit të planifikimit të rezervave të tepërta në sistem.

Situata e shëndoshë fiskale në të cilën po kalonte vendi si dhe të ardhurat e konsiderueshme, që u siguruan nga privatizimi i ndërmarrjeve strategjike të ekonomisë e lehtësuan shumë procesin e krijimit të rezervave të tepërta. Gjithashtu, në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë shfrytëzoi mundësinë e përdorimit të kredisë direkte për të financuar nevojat e qeverisë, mundësi e cila ishte planifikuar të përdorej dhe në programin monetar për vitin 2000 të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Gjatë gjithë periudhës niveli i rezervave të tepërta ka ardhur vazhdimisht në rritje duke u luhatur në mesin e tetorit rreth nivelit 8 miliardë lekë. Kjo politikë e ndjekur nga ana e Bankës së Shqipërisë ishte e kushtëzuar nga sjellja e bankave të nivelit të dytë, të cilat nuk po reagonin, në masën e duhur, në drejtim të nivelit të normave të interesit. Niveli i rezervave të tepërta u përdor me sukses në kushtet kur Banka e Shqipërisë kërkonte të ulte normat e interesit.

#### ***B. INSTRUMENTE NË DISPOZICION: ANKANDET JAVORE REPO.***

Që në fillim ky instrument u konceptua të operonte në krahun e tërheqjes së likuiditetit nga tregu, në mënyrë që të përputhej dhe me ndryshimin e qëndrimit të Bankës së Shqipërisë, nga pasiv në aktiv. Tërheqja ose injektimi i likuiditetit nga/në treg do të realizohet nga ndryshimi i portofolit repo. Përvoja tremujore në përdorimin e ankandeve repo tregoi se Banka e Shqipërisë mund ta përdorë këtë instrument, në të dyja drejtimet, në varësi të nivelit të rezervave të tepërta në sistem.

Për sa i përket nivelit të normave të interesit, Banka e Shqipërisë synon që ta përdorë këtë instrument edhe si “zbulues të çmimit”, me qëllim që këtë rol të mos e luajë vetëm tregu primar i bonove të thesarit. Kjo do ta ndihmojë Bankën, që në të ardhmen, jo vetëm të ndryshojë targetin e saj operacional nga interesi për bonot e thesarit tremujore në interesin për ankandet repo, por edhe të krijojë kushtet për të zhvilluar tregun e parasë për periudha më të shkurtra se tre muaj.



Në vazhdim të rritjes së transparencës, në kuadrin e zbatimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë vazhdon të mbajë kontakte me bankat e nivelit të dytë me qëllim që të shpjegojë veprimet e kryera prej saj.

Për të ardhmen është e nevojshme që Banka të përcaktojë qartë strukturën e instrumenteve, që do të përdorë dhe qëllimin e përdorimit të tyre. Për realizimin e kësaj detyre ka filluar punën Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare.

#### **5. Cila është ecuria e tregut të këmbimeve valutore gjatë 10 muajve të parë të vitit 2000?**

Karakteristikë e kësaj periudhe ka qenë zhvlerësimi i lekut kundrejt dollarit amerikan dhe vlerësimi i tij kundrejt markës gjermane. Ai ka lëvizur në të njëjtin drejtim dhe kundrejt liretës italiane dhe dhrahmisë greke.

Gjatë periudhës, kursi i këmbimit të lekut me valutat kryesore është përcaktuar, në pjesën më të madhe të kohës, nga kërkesa dhe oferta për valutë, e ndikuar vazhdimisht nga faktorë ciklikë, që lidhen me karakteristikat e tregtisë së vendit tonë.

Ndikim të rëndësishëm në kursin e këmbimit të monedhave kanë pasur edhe luhatjet në tregun ndërkombëtar të këmbimeve valutore, ku një zhvlerësim thuajse i vazhdueshëm i euros kundrejt dollarit amerikan ka ushtruar presion për dobësimin e raportit dem/lekë dhe rritjen e raportit usd/lekë.

Niveli i lartë i importeve në katër muajt e parë të vitit, i shoqëruar me dobësimin e euros kundrejt dollarit amerikan, bëri që dollari amerikan të fitojë 7.0 për qind kundrejt lekut dhe marka gjermane të bjerë me 1.1 për qind.

Në dy javët e para të muajit maj, leku u dobësua globalisht me rreth 3.0 për qind pas lajmeve në treg se Banka e Shqipërisë është e interesuar për një dobësim të lekut për shmangien e presioneve deflacioniste.

Mbarimi i periudhës së importeve dhe fillimi i periudhës së të hyrave në valutë nga emigrantët, sollti gradualisht forcimin e lekut dhe në fund të muajit gusht, leku ishte më i fortë se në fund të prillit si ndaj markës gjermane (66.5 lekë kundrejt 68.00 lekë) ashtu dhe ndaj dollarit amerikan (141.50 lekë kundrejt 145 lekë). Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë filloi të kuotonte në blerje në sistemin bankar, për të mos lejuar dobësim

të shpejtë të monedhave europiane, të gjendura nën presion edhe nga rënia në tregun ndërkombëtar. Këto blerje u intensifikuan gjatë javës së fundit të gushtit, në të cilën raporti dem/lekë u ngjiti në nivelin 68.00, megjithë dobësimin e euros në tregun ndërkombëtar. Kështu Banka e Shqipërisë ka blerë që nga fillimi i vitit 2000 deri në mes të muajit nëntor 35.5 milionë usd nga sistemi bankar, ndërkohë që bleu nga Ministria e Financave 52.7 milionë usd.

Gjatë muajit shtator raporti usd/lekë është luhatur rreth nivelit 148.00 lekë, ndërkohë që presionet për rënien e raportit dem/lekë kanë qenë të dukshme. Në fund të muajit shtator, ECB filloi të ndërhyjë në tregun e këmbimeve valutore në mbështetje të euros, gjë që ka shkaktuar luhatje në tregun ndërkombëtar. Në tregun e brendshëm ka pasur një qëndrueshmëri të kërkesës dhe ofertës për valutë, por lëvizjet në tregun ndërkombëtar kanë ndikuar vazhdimisht kurset e këmbimit të monedhave të veçanta. Gjatë javëve të ardhme deri në fund të vitit, mendojmë se situata do të jetë e ngjashme.

#### **Rezervat valutore.**

Niveli i rezervave valutore në fillim të periudhës ka qenë rreth nivelit 481 milionë usd, ndërsa në datën 14 nëntor 2000 kjo rezervë kap nivelin 563 milionë usd. Karakteristikë, për këtë periudhë, ka qenë trendi rritës, i cili ka qenë më i pjerrët gjatë gjashtëmujorit të dytë. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë rritje kanë qenë:

- 1- Blerjet e bëra nga Banka e Shqipërisë (BoA) në sistemin bankar si dhe ndaj Ministrisë së Financave.
- 2- Disbursimet e donatorëve (kryesisht FMN, KE) në favor të Bankës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Financave.

Sipas programit të saj monetar niveli i rezervave bruto në fund të vitit duhet të jetë rreth 550 milionë usd gjë që i jep Bankës së Shqipërisë komoditetin për të qenë e sigurt në realizimin e këtij treguesi.

#### **6. Si ka qenë kreditimi i ekonomisë nga sistemi bankar?**

Qëllimi kryesor i çdo programi makroekonomik afatgjatë është rritja e qëndrueshme ekonomike. Në këtë kuadër, investimet në aktivitete reale prodhuese marrin një rol të veçantë, të cilit i duhet kushtuar mjaft rëndësi.



Rëndësia e kredisë bankare, sidomos në tregje të pazhvilluara financiare, për financimin e ekonomisë është e njohur dhe e pranuar. Në këtë drejtim, pikëpamja e Bankës së Shqipërisë është se, pa u shmangur nga objektivi primar i saj, i cili është ruajtja e stabilitetit të çmimeve, duhet bërë më shumë në drejtim të mbështetjes së ekonomisë me financimin e nevojshëm.

Gjatë vitit 2000, Banka e Shqipërisë u bë iniciuese e një fushate për kreditimin e ekonomisë nëpërmjet sistemit bankar.

Kjo fushatë u organizua në formën e takimeve në nivele të ndryshme institucionale me pjesëmarrjen e bankave të nivelit të dytë, komunitetit të biznesit, medias dhe organeve ligjvënëse e ekzekutive. Me anë të fushatës do të synohej një rritje e aktivitetit kreditues duke thithur mendimet dhe kërkesat e biznesit bankar dhe të pjesës tjetër.

Në takimet e ndryshme, u bë e qartë se duhej të arrihej edukimi i biznesit shqiptar nëpërmjet bisedave, publikimeve, asistencës dhe konsulencës financiare profesionale, që mund të jepet nga organe të specializuara brenda bankës apo jashtë saj (për hartimin e planbizneseve).

E rëndësishme është që të bëhet e njohur te klientët se si mund të merret një kredi në bankë, çfarë kushtesh janë të detyruar të plotësojnë bizneset dhe individët për të qenë huamarrës në banka. Kjo duhet të shoqërohet me fletëpalosje dhe stenda të vendosura në ambientet e pritjes së bankës.

Për rritjen e transparencës së aktivitetit kreditues të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ofroi mundësitë e veta të publikimit. Për këtë jemi gjithmonë në pritje të projekteve nga bankat e nivelit të dytë. Veç publikimeve u ofrua dhe faqja e internetit të Bankës së Shqipërisë për informacionet që ato dëshirojnë.

Po si paraqitet situata e kreditimit nga sistemi bankar gjatë vitit 2000? Sistemi bankar në drejtim të kreditimit të ekonomisë nga janari deri në fund të muajit shtator 2000, është karakterizuar nga një përfshirje më aktive në krahasim me tre vitet e fundit. Si nëntëmujor, niveli i akordimit të kredive të reja ka arritur në masën 17.2 miliardë lekë, kur për dy vitet e fundit 1998-1999 ai arriti rreth 14 miliardë lekë.

Për vitin 2000, kredia për ekonominë në programin monetar është parashikuar të rritet 7.5 miliardë lekë. Gjatë periudhës dhjetor 1999 -

shtator 2000, kredia për ekonominë është rritur me 5,29 miliardë lekë, nga e cila 5,27 në valutë dhe 0,02 në lekë ose, sipas programit, është realizuar 70,5 për qind.

Në tremujorin e tretë të vitit 2000 teprica e kredisë si sistem bankar, në krahasim me tremujorin e dytë '00 është rritur me 2,5 miliardë lekë, në një kohë që ekonomia për gjithë vitin 1999 u kreditua me 2,2 miliardë lekë.

Përsa i përket afateve të lëvrimit kredia afatshkurtër dhe ajo afatmesme janë rritur respektivisht me 2,7 dhe 2,3 miliardë lekë, ndërsa kredia afatgjatë me 0,29 miliardë lekë.

Duke iu referuar shifrës 17,2 miliardë lekë (kredi e re) që nga fillimi i vitit situata është:

- 14,5 miliardë lekë kredi në valutë
- 8,8 miliardë lekë janë kredi afatshkurtër.

Dominimi i kredisë në valutë ndaj rritjes së stokut të kredisë gjithsej mendojmë se vjen nga:

- \* rritja e madhe e depozitave në valutë i nxit bankat që një pjesë të këtyre burimeve t'i investojnë në tregun e huadhënies dhe njëkohësisht të mos ekspozohen nga rreziku i kursit të këmbimit. Në këtë kontekst, duhet theksuar se kredia për ndërtim zë një peshë të konsiderueshme;
- \* interesat e kredive në valutë janë më tërheqëse se ato në lekë.

Mbështetur në treguesit e mësipërm evidentojmë një kthesë të orientimit të bankave në këtë investim të burimeve të tyre, që është me interes trepalësh bankë-biznes-rritje ekonomike.

Kreditë janë akorduar, thuajse tërësisht, për sektorin privat të ekonomisë e për individët. Bankat më aktive në tregun e huadhënies, janë Banka Italo -Shqiptare, Banka Tirana, Banka Fefad, Banka Amerikane dhe Banka Alfa Kredit. Kështu Banka Italo - Shqiptare ka dhënë rreth 37,4 për qind të kredive të reja, ndërsa Banka Fefad dhe Banka Tirana në totalin e kredisë së akorduar zënë rreth 17,8 për qind dhe 16,2 për qind.

Nga të dhënat e raportuara për bizneset, që janë kredituar nëpërmjet sistemit bankar, 29 për qind të kredive e kanë marrë aktivitetet e ndërtimit, rreth 23 për qind tregtia, rreth 17 për qind industria përpunuese, 5 për





qind hotelet dhe restorantet, 8 për qind pasuritë e patundshme dhe pjesën tjetër bujqësia, peshkimi, transporti, shërbimet etj.. Mesatarisht ekonomia është kredituar 0.6 miliardë lekë çdo muaj.

Për periudhën tetor - dhjetor 2000 pritet që ekonomia të kreditohet edhe me afro 2 miliardë lekë të tjera. Në qoftë se shohim rritjen e stokut të kredisë nga një tremujor në tjetrin për vitin 2000 të paraqitur sipas tabelës më poshtë:

**Tabela 3. Tregues të kredisë.** në miliardë lekë

Treguesit	1998	1999	T-1 '00	T-2 '00	T-3 '00
Teprica e kredisë si sistem bankar	17.7	19.9	21.4	22.7	25.2
Rritja e stokut të kred. nga një tremujor në tjetrin		2.2	1.5	1.3	2.5

mendojmë se, po të ruhet niveli mesatar mujor i kreditimit në tremujorin e tretë '00 (0,8 miliardë lekë), do të arrihet parashikimi në programin monetar për kreditimin e ekonomisë në fund të vitit 2000 (7,5 miliardë lekë). Kjo, nisur dhe nga praktika e viteve të kaluara, që në tremujorin e tretë dhe të katërt bankat akordojnë më shumë kredi.

## 7. Si ka qenë ecuria e depozitave në sistemin bankar?

Në fund të muajit shtator të vitit 2000, paraja gjithsej (M3) është rritur 13.4 për qind në nivel vjetor. Ritmi vjetor i rritjes së ofertës së parasë ka ardhur duke u ulur dhe për muajin shtator shënon nivelin më të ulët të regjistruar më parë.

Depozitat në lekë kanë rënë në 156.7 miliardë lekë në shtator '00, nga 158.3 miliardë lekë në fund të vitit 1999. Në këtë rënie ka ndikuar si rënia e depozitave pa afat në lekë (nga 21.6 miliardë lekë në 20.9 miliardë lekë) ashtu edhe rënia e depozitave me afat në lekë (nga 136.6 miliardë lekë në 135.7 miliardë lekë). Depozitat e kursimit në lekë, të cilat përbëjnë elementin më të madh të ofertës së parasë, në fund të muajit shtator përbëjnë 43.5 për qind të ofertës së parasë.

Pesha që ky grup depozitash zë ndaj totalit është në rënie të vazhdueshme. Ulja e peshës argumentohet me ritmet e ulta të rritjes së depozitave me afat në lekë. Ulja e ritmeve të rritjes së depozitave është e vështirë të shpjegohet, por Banka e Shqipërisë mendon se ulja e përqindjes së interesit është reflektuar në vendimet e investitorëve dhe

të kursimtarëve për gjetjen e alternativave të tjera sidomos në investime prodhuese, bono thesari, depozita në valutë etj.. Nga ana tjetër, ulja graduale dhe në mënyrë të vazhdueshme e normës së interesit ka reduktuar ndjeshëm edhe nivelin e interesave, që kapitalizohen në stokun e depozitave pas maturimit dhe riinvestimit të depozitave. Depozitat në valutë kanë ruajtur ritme më të larta rritjeje për këtë vit krahasuar me një vit më parë. Stoku i depozitave në valutë është rritur nga 53.2 miliardë lekë në fund të vitit 1999, në 63.0 miliardë lekë në shtator 2000. Kjo rritje mbart në vetvete efektin e kursit të këmbimit (llogaritet që ndryshimi i kursit të këmbimit nga fillimi i vitit të ketë një efekt rreth + 1,5 miliardë lekë) dhe preferencën e kursimtarëve për të mbajtur depozita në valutë. Preferenca e publikut për depozita në valutë ka ardhur edhe si pasojë e ngushtimit të diferencave midis normës së përqindjes në lekë dhe në valutë, dhe të ecurisë së kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor.

#### **8. Cilat janë zhvillimet në tregun e kapitaleve dhe në veçanti në Bursën e Tiranës?**

Zhvillimi i tregut të kapitaleve lë ende shumë për të dëshiruar. Aktiviteti i Departamentit të Bursës në Bankën e Shqipërisë ka qenë i mefshët. Gjatë vitit 2000 në sesionet e Bursës së Tiranës nuk është ekzekutuar asnjë transaksion në letrat me vlerë.

##### **\* Bonot e thesarit.**

**Shkaku kryesor për këtë mungesë transaksionesh në bonot e thesarit është rreshtimi i bankave që marrin pjesë në këtë treg vetëm në pozicionin e blerësit dhe mosekzistenca e asnjë oferte për shitje të bonove të thesarit. Rrjedhimisht, nuk mund të kemi kryqëzim transaksionesh dhe ekzekutim të tyre.**

##### **\* Aksionet.**

Ende në Bursën e Tiranës nuk kemi të kuotuar asnjë aksion të ndonjë shoqërie. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i:

- mospërbushjes së kriterëve cilësore të kuotimit në bursë, të tilla si: aftësi të spikatura në menaxhim dhe prodhim raportesh financiare cilësore e transparente;
- mosekzistencës, në shumë raste, të një pozite të shëndoshë financiare të ndërmarrjeve;
- mosinteresimit të këtyre të fundit për të listuar aksionet e tyre në



listën zyrtare të Bursës së Tiranës dhe rrjedhimisht, i mosdëshirës së tyre për t'u kthyer në shoqëri aksionere publike e për të ngritur kapital nëpërmjet Bursës.

Megjithatë, gjatë këtij viti janë shënuar dhe disa hapa pozitivë si më poshtë:

1. kompletimi i bazës ligjore, që rregullon funksionimin dhe aktivitetin e Bursës së Tiranës; dhe
2. ndërmarra e një fushate promovimi për Bursën e Tiranës dhe për instrumentet financiare, në përgjithësi.

Për sa i përket çështjes së shkëputjes së Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë dhe themelimit të saj si institucion i pavarur, dëshirojmë të deklarojmë se, së fundi, Komiteti i Politikave Ekonomike miratoi projektligjin "Mbi disa ndryshime në ligjin nr.8080, datë 01.03.1996, "Për letrat me vlerë", të propozuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë.

Ky projektligj pritet të shqyrtohet së shpejti në Këshillin e Ministrave dhe, më tej, të paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Miratimi i tij do të shënojë një hap pozitiv në drejtim të realizimit të shkëputjes përfundimtare të Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë dhe do të krijojë premisa për themelimin e saj si një institucion i pavarur. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë po punon për organizimin e një aktiviteti sensibilizues për problemet dhe perspektivat e aktivizimit të tregut të kapitaleve dhe më konkretisht të Bursës së Tiranës.

#### **9. Cilat janë objektivat kryesorë të programit monetar të Bankës së Shqipërisë të diskutuar së fundi me FMN për vitin 2001?**

Mbështetur në ecurinë e deritanishme të politikës monetare, të inflacionit, të tregut monetar dhe të këmbimeve valutore si dhe të zhvillimeve institucionale, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të ndjekë objektivin kryesor të saj të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve në nivele të ulta të vërtetuara tashmë në tri vitet e fundit.

Bazuar në këto zhvillime, si dhe në bashkëpunim me FMN, në kuadër të zbatimit të programit PRGF (Reduktimit të Varfërisë dhe Lehtësimit të Rritjes Ekonomike), janë rishikuar objektivat për vitin 2000 si dhe janë përcaktuar objektivat për vitin 2001, si më poshtë:

**Tabela 4. Tregues makroekonomikë.**

Treguesi (në %)	Objektivi	
	Viti 2000	Viti 2001
1. Rritja e PBB-së.	7.8	7.3
2. Norma vjetore e inflacionit.	2 - 4	2 - 4
3. Rezervat valutore në muaj importe mallrash e shërbimesh.	4.4	4.6
4. Deficiti i llogarisë korente në për qind ndaj PBB-së.	7.1	7.0
5. Deficiti i përgjithshëm buxhetor në për qind ndaj PBB-së.	9.5	9.1

Për përcaktimin e këtyre objektivave dhe të treguesve kryesorë sasiorë të programit monetar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2001 nga 16-31 tetor të këtij viti u bënë bisedime me Qeverinë dhe FMN.

Në hartimin e programit monetar të Bankës së Shqipërisë i kushtohet vëmendje e veçantë realizimit të objektivit kryesor të saj, ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Banka e Shqipërisë synon të mbajë nën kontroll ofertën monetare duke e parë rritjen e saj si një shpjegues më të mirë të inflacionit. Prandaj, duke u nisur nga :

- \* parashikimet për një rritje të prodhimit të përgjithshëm real bruto (PPB real) prej 7.3 për qind në vitin 2001;
- \* parashikimet dhe konsideratat se një rritje e nivelit të inflacionit në intervalin 2 - 4 për qind për vitin 2001 do të jetë e arsyeshme dhe e dobishme për ekonominë shqiptare;
- \* konstatimet se shpejtësia e qarkullimit të parasë për vitin 2000 ka qenë e qëndrueshme dhe se s'ka arsye të besohet për një ndryshim të saj në vitin 2001;

rritja e ofertës së parasë (agregati M3) për vitin 2001, parashikohet dhe synohet të jetë në masën 11.2 për qind .

Për kompozimin e kësaj oferte monetare sipas agregatëve të ndryshëm, në program janë patur parasysht dy prirje të rëndësishme të vërejtura gjatë vitit 2000:

- \* rritja e raportit të parasë jashtë bankave ndaj parasë gjithsej; dhe
- \* rritja e raportit të depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave.

Në përputhje me tendencën e rritjes së raportit të parasë jashtë bankave ndaj parasë gjithsej, në program është parashikuar që ky raport për vitin 2001 të jetë 29 për qind dhe paraja jashtë bankave të rritet me 10.7



miliardë lekë.

Gjithashtu, supozohet se edhe tendenca e rritjes së pjesës së depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave do të vazhdojë dhe për vitin 2001, duke patur parasysh se :

- \* edhe për këtë vit normat e interesit do të vazhdojnë të favorizojnë depozitat në valutë;
- \* zhvillimet politike dhe elektorale në vitin 2001 mund të shoqërohen me një zhvendosje të preferencave të agjentëve ekonomikë drejt valutës, një prirje kjo që gjen konfirmim edhe në historikun e dukurive ekonomike në Shqipëri.

Në përputhje me këto supozime, depozitat në total janë parashikuar të rriten me 26.2 miliardë lekë gjatë vitit 2001, ku përfshihet një rritje prej 16.4 miliardë lekësh të depozitave në lekë (rritje prej 9.7 për qind krahasuar me stokun e parashikuar të këtyre depozitave në dhjetor '00).

Pjesa tjetër e rritjes së totalit të depozitave do të marrë formën e një rritjeje prej 9,8 miliardë lekësh të depozitave në valutë (rritje prej 15.1 për qind krahasuar me stokun e parashikuar në dhjetor '00). Si rrjedhim, do të kemi një ulje të pjesës që zë oferta monetare në lekë (M2) ndaj ofertës monetare gjithsej ( M3 ) nga 80.19 për qind në vitin 2000 në 79.51 për qind në vitin 2001.

Kreditimi i sistemit bankar për ekonominë është parashikuar të jetë 8.1 miliardë lekë ose një rritje prej 8 për qind krahasuar me nivelin e parashikuar të realizohet ky kreditim në vitin 2000. Duke qenë se niveli i kreditimit të ekonomisë deri në shtator 2000 është realizuar deri në masën 70 për qind, një parashikim i tillë konsiderohet i realizueshëm dhe është konsistent edhe me shifrat e tjera të programit monetar.

Teorikisht, për financimin e deficitit buxhetor ekzistojnë dy burime, financimi i brendshëm dhe financimi i jashtëm.

Financimi i jashtëm i deficitit buxhetor reflektohet në ndryshimin e mjeteve të huaja neto të Bankës së Shqipërisë. Në program është parashikuar një rritje e mjeteve të huaja neto të Bankës së Shqipërisë prej 11.3 miliardë lekësh që nënkupton këtë financim të jashtëm.

Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor nga sistemi bankar është parashikuar në buxhetin e shtetit në masën 17.8 miliardë lekë ose 2.8

për qind e PBB ndërsa financimi i deficitit buxhetor nga ana e autoritetit monetar është parashikuar brenda limiteve të lejuara nga ligji.

Një përbërës tjetër i kërkesës për para, parë nga pikëpamja e aktivitetit, janë dhe mjetet e huaja neto (MHN). Në tërësi, mjetet e huaja neto të sistemit bankar janë parashikuar të rriten me 11 miliardë lekë. Mjetet e huaja neto të Bankës së Shqipërisë janë parashikuar të rriten me 11.3 miliardë lekë duke u mbështetur në një rritje të rezervave bruto prej 70 milionë usd. Mjetet e huaja neto të bankave tregtare janë parashikuar të ulen me 0.3 miliardë lekë.

Përveç treguesve kryesorë makroekonomikë, të inflacionit, treguesve monetarë, të deficitit të buxhetit etj., në bisedimet me FMN u diskutuan edhe probleme të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit bankar. Kështu u theksua domosdoshmëria e mbylljes *de facto* të procesit të privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, gjë e cila tashmë u realizua, si dhe probleme të rikapitalizimit të Bankës së Kursimeve. Kjo e fundit u theksua nga Banka e Shqipërisë si kusht i vazhdimit me sukses të privatizimit të Bankës së Kursimeve.

Një tjetër objekt i diskutimeve ishte edhe mundësia e zhvillimit të mëtejshëm gjatë vitit 2001, të tregut monetar, të tregut të bonove të thesarit dhe përdorimit të instrumenteve indirekte të kontrollit. Banka e Shqipërisë u inkurajua nga misioni i FMN që të vazhdojë punën e nisur me sukses të zëvendësimit të instrumenteve direkte me ato indirekte, në drejtim të përmirësimit të teknikave operacionale dhe të rritjes së fleksibilitetit të veprimeve. Përsosja e menaxhimit monetar u konsiderua, në këto diskutime, si një prioritet për Bankën e Shqipërisë në vitin 2001. Diskutime u kryen edhe për mundësinë e përsosjes së tregut të letrave me vlerë të qeverisë si dobësimin e situatës monopol në këtë treg, aktivizimin e zyrave postare krahas bankave, tërheqjen e individëve në këtë treg, zhvillimin e tregut sekondar të bonove të thesarit etj..

Me misionin e FMN u diskutuan, gjithashtu, probleme të përmirësimit dhe të pasurimit të kuadrit ligjor, që lidhet me sistemin bankar, si ecuria me draftin e projektligjit "Për sigurimin e depozitave", amendimin e ligjit për Bankën e Shqipërisë etj..

\* Situatat monopol në sistemin bankar.

Kështu, sistemi financiar në tërësi në Shqipëri dominohet nga sistemi bankar. Ende nuk janë krijuar ose janë në faza fillestare institucionet



financiare, tregjet e kapitalit etj, dhe në mënyrë të vetvetishme lënë hapësira dhe krijojnë pozita favorizuese për bankat. Nga ana tjetër, sistemi bankar dominohet nga banka tregtare universale. Nuk ka banka kooperativë, banka zhvillimi apo banka investimi.

Dominimi i tregut nga Banka e Kursimeve është mjaft i lartë në aktivitetin total të sistemit bankar, në aktivitetin depozitues, kryesisht atë në lekë, në investimin në tregun e bonove të thesarit, në rrjetin bankar dhe të vëllimit e procedurave të pagesave. Ndërsa, në tregun e kreditit vërehet sundim i Bankës së Kursimeve nisur nga teprica e kredisë, por, në realitet, për shkak të vendimeve administrative të marra, ajo nuk luan dot ndikim në të. Ndikimi më i dukshëm (i konsiderueshëm) mbetet ai në tregun e bonove të thesarit.

\* Situata e dominimit të tregut bankar ka shkaktuar disa pasoja negative.

- Ul efektivitetin e politikës së interesave të Bankës së Shqipërisë dhe nuk lejon përcaktimin e çmimeve, si ai i bonove të thesarit dhe kreditit, mbi bazën e tregut. Në këtë mënyrë, megjithë situatën e favorshme ekonomike, financimi i ekonomisë mbetet i kushtueshëm.
- Ul efikasitetin e mekanizmit të transmisionit të vendimeve në ekonomi dhe po pengon zbatimin me ritëm më të shpejtë të instrumenteve indirekte të politikës monetare.
- Mban të larta kostot e ofrimit të shërbimeve për klientët.

Banka e Shqipërisë, gjithashtu, po studjon përvojën botërore në bashkëpunim me institucione financiare ndërkombëtare për njohjen dhe mundësinë e përshtatjes së *inflation targeting* në kushtet e Shqipërisë, si një alternativë monetare në një të ardhme jo të largët.

## **II. ZHVILLIMET NË MBIKËQYRJEN E SISTEMIT BANKAR**

### **10. Cilat janë rezultatet e mbikëqyrjes së sistemit bankar gjatë këtij viti?**

Rezultatet e nëntëmujorit tregojnë që sistemi bankar në tërësi paraqitet me tregues në rritje dhe kjo krahasuar jo vetëm me fundvitin '99, por edhe nga një tremujor në tjetrin të këtij viti.

Përsa i përket zgjerimit të sistemit bankar, gjatë vitit 2000, nuk është licencuar asnjë bankë apo degë bankash të reja. Megjithatë, sipas

informacioneve tona, gjatë vitit 2000 bankat tashmë të licencuara kanë zgjeruar rrjetin e veprimtarisë së tyre edhe me 7 degë të reja në rrethe të ndryshme të vendit. Kështu, Banka Tirana ka hapur degë në Gjirokastrë; Banka Alfa në Durrës dhe në Elbasan; Banka Fefad në Durrës, Elbasan, Fier dhe Korçë.

Duke filluar nga fundviti 1999, Banka e Shqipërisë në ekzaminimin e institucioneve financiare (bankave), për të vlerësuar gjendjen e përgjithshme financiare të tyre, filloi të aplikojë përvojën e vlerësimit mbi bazën e sistemit të klasifikimit “**CAMELS**”, që vlerësohet si një nga përvojat më të përparuara, në fushën e mbikëqyrjes bankare. Këtë përvojë Këshilli Mbikëqyrës e formalizoi me vendimin nr. 62, datë 05.07.2000.

Në mbështetje të strategjisë së zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, aktualisht, është arritur që çdo bankë t'i nënshtrohet ekzaminimit të përgjithshëm (të plotë) një herë në 12 muaj gjë që vlerësohet si një ndër arritjet pozitive për mbikëqyrjen bankare, sipas praktikave e standardeve ndërkombëtare.

Gjithashtu, Departamenti i Mbikëqyrjes - Sektori i Inspektimeve, realizon ndjekjen e ecurisë së gjendjes financiare të bankave në mënyrë periodike, ku çdo muaj dhe çdo tre muaj kryen analiza *off-site* (mbikëqyrje nga jashtë).

Ekzaminimet e kryera gjatë dhjetëmujorit, tregojnë se bankat po rrisin nivelin e administrimit dhe kanë gjendje të sigurtë financiare. Janë fuqizuar elementet bazë të të ardhurave si marzhi neto i interesave, cilësia e aktiveve dhe efikasiteti. Shumica e bankave kanë një kapital rregullator disa herë më të lartë se ai i kërkuar nga Banka e Shqipërisë.

Nga ana e Bankës së Shqipërisë janë kryer 9 ekzaminime të plota të bankave, dhe po inspektohen dhe dy të tjera me synim që brenda muajit dhjetor të ekzaminohen të gjitha bankat, duke arritur që këtë vit objektivin strategjik të Bankës së Shqipërisë, që në vitin 2001 të gjitha bankat të ekzaminohen 1 herë në 12 muaj. Mbështetur në vlerësimin e kryer nga ekzaminimet në vend dhe në vlerësimin nëpërmjet analizave, gjendja e përgjithshme financiare e sistemit bankar, **vlerësohet relativisht e shëndoshë.**

Këshillat drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë të bankave, kanë reaguar pozitivisht ndaj kërkesave dhe rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë





lidhur me : (i) përmirësimet e duhura në politika dhe procedura të aktiveve huadhënëse; të veprimtarisë valutore; të administrimit të riskut etj. (ii) rritjen e pavarësisë së kontrollit të brendshëm; (iii) administrimin e aktiveve dhe të pasiveve; (iv) zbatimin e manualit të kontabilitetit bankar; (v) zhvillimet strategjike të bankave; (vi) sigurimin e akteve të brendshme të nevojshme për operacione të reja etj.. Banka e Shqipërisë ka vendosur kontakte të drejtpërdrejta me këshillat drejtues të bankave me qëllim rritjen e përgjegjësisë së drejtimit për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore e për një veprimtari të sigurtë bankare.

Banka e Shqipërisë po rrit vazhdimisht shkallën e familjarizimit të bankave e të administratorëve të tyre, me sistemin vlerësues (sistemi i vlerësimit CAMELS) që përdoret për vlerësimin e gjendjes së institucioneve financiare (bankave).

**Totali i bilancit** për sistemin bankar krahasuar me fundvitin '99 është rritur për 3,2 për qind ose 8 miliardë lekë. Në rritjen e këtij treguesi kanë ndikuar kryesisht bankat private. Kështu, totali i bilancit për këtë grup bankash, në krahasim me fundvitin '99 paraqitet me rritje 56,6 për qind ose rreth 18,3 miliardë lekë çka tregon jo vetëm besueshmërinë në rritje të këtyre bankave, por edhe përmirësimin e cilësisë dhe të shpejtësisë së kryerjes së shërbimeve të ndryshme bankare të këtij grupi bankash.

Ndonëse shifrat janë në kufijtë e sipërpërmendur, përsëri janë bankat me kapital shtetëror, që vazhdojnë të dominojnë sistemin bankar ndonëse me tendencë në ulje. Ky konkluzion shprehet edhe në treguesit e mëposhtëm :

- \* totali i bilancit të bankave me kapital shtetëror përfaqëson 73,7 për qind të sistemit bankar;
- \* bankat e përbashkëta 6,9 për qind ;
- \* ndërsa bankat private dhe degët e bankave të huaja përfaqësojnë 19,4 për qind.

\* **Ecuria e llogarive dhe e depozitave të klientëve.**

Sektori bankar privat po investon në drejtim të teknikave bankare bashkëkohore duke tërhequr klientë të ndryshëm pranë tij nëpërmjet shërbimeve të shpejta. Këtë e tregon më së miri rritja e llogarive rrjedhëse të klientëve pa nënvlerësuar edhe rritjen e depozitave me afat. Kështu, në të dhënat e mëposhtme jepet situata dhe krahasimi me fundvitin '99:

- \* sistemi bankar paraqitet me rritje në llogaritë rrjedhëse për 2,1 miliardë lekë në një kohë që në bankat private (2 grupet e tjera së bashku) ky tregues paraqitet me rritje për 4,5 miliardë lekë;
- \* depozitat me afat për sistemin bankar janë rritur për 9,8 miliardë lekë dhe nga këto 9,7 miliardë lekë, janë rritur në bankat private.

Rritja dhe zhvillimi i aktivitetit të bankave private (në aktivitetin kredidhënës) ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e **cilësisë së portofolit të huave**.

Sistemi bankar rreth 44,7 për qind të kredive i klasifikon si kredi standarde, duke ndikuar ndjeshëm në këtë tregues bankat e përbashkëta dhe private.

Konkretisht për grup bankash ky tregues paraqitet :

- \* bankat me kapital shtetëror vetëm 8,8 për qind të kredive i klasifikojnë si kredi standarde;
- \* bankat e përbashkëta 66,6 për qind ;
- \* bankat private dhe degët e bankave të huaja 89,6 për qind.

E kundërta ndodh me kreditë e klasifikuara si kredi të humbura.

Kështu, ndërsa si sistem bankar kreditë e humbura përfaqësojnë rreth 42,5 për qind të kredive të klasifikuara, për grup bankash ky tregues paraqitet :

- \* bankat me kapital shtetëror rreth 85 për qind të kredive i klasifikojnë si kredi të humbura;
- \* bankat e përbashkëta 2,8 për qind;
- \* bankat private dhe degët e bankave të huaja 2,3 për qind.

Pra, siç shihet, në treguesin e kredive të humbura një ndikim negativ kanë bankat me kapital shtetëror, por theksojmë se ky problem në këto banka është i trashëguar në vite duke detyruar Bankën e Shqipërisë të marrë masën e ndërprerjes së aktivitetit kredidhënës kundrejt këtyre bankave.

Vetëm në Bankën e Kursimeve, për tre vitet e fundit, situata e portofolit të huave në tërësi paraqitet si më poshtë:



Tabela 5. Cilësia e kredisë.

në milionë lekë

Periudha	Teprica e kredisë (principali+interesa)	Provizijone të krijuara (principali+interesa)	Raporti në % (proviqj./tepricës së kredisë)
1998	13122.5	9834.9	74.9
1999*	12674.0	10749.5	84.8
9/mujori 2000	12156.6	10650.0	87.6

\* Këtu është zbritur shuma prej 1.230 milionë lekësh.

Duhet thënë se, megjithëse në fund të shtatorit teprica e kredisë për bankat private, krahasuar me fundvitin '99, është rritur 5,7 miliardë lekë, nga ana jonë vlerësohet se mund të bëhet edhe më shumë. Kjo nisur edhe nga fakti që janë vetëm këto banka, që ushtrojnë këtë aktivitet, ndërkohë që dy bankave me kapital shtetëror u është ndërprerë ky aktivitet. Bankat private dhe të përbashkëta paraqiten **mjaft të kapitalizuara**. Kështu raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat private është në nivelin 42,2 për qind kundrejt 12 për qind që është norma e lejuar. Një nivel kaq i lartë i këtij treguesi i jep mundësi këtyre bankave për një investim më të madh në ekonominë shqiptare sidomos nëpërmjet kredidhënies.

#### \* **Rezultati financiar.**

Në fund të shtatorit fitimi i realizuar nga sistemi bankar është rreth 2,7 miliardë lekë nga 1,3 miliardë lekë të rezultuar në fundvitin '99, duke ndikuar në përmirësimin e treguesve të rentabilitetit për sistemin bankar dhe për çdo bankë në veçanti. Nga 13 banka, që përbëjnë sistemin bankar në Shqipëri vetëm 3 banka kanë mbyllur aktivitetin e tyre me humbje, ndërsa 10 të tjerat rezultojnë me fitim. Në këtë tregues, më mirë paraqiten bankat me kapital shtetëror ndonëse edhe disa nga bankat e përbashkëta dhe private paraqiten në nivele të kënaqshme dhe me tendencë në rritje.

### **III. ZHVILLIMET NË FUNKSIONET E TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

#### **11. Cila është ecuria në zhvillimin e sistemit të pagesave dhe kontabilitetit?**

##### **a. Sistemi i pagesave.**

Megjithëse Banka e Shqipërisë ka vazhduar punën edhe gjatë vitit 2000 për realizimin e objektivave të sektorit të pagesave mund të themi se ende nuk ka një progres të dukshëm. Puna e deritanishme ka ndjekur këto drejtime kryesore:

1. Standardizimi i instrumenteve të pagesës në përdorim. Megjithëse ky objektivi kërkon një proces të gjatë në realizimin e tij, pasi përfshin një gamë të tërë instrumentesh pagese dhe problemesh, muajt që kaluan shënuan fillimin e kësaj pune me marrëveshjen "Për unifikimin e urdhërpagesave dhe çekut".
2. Ushtrimi i rolit nxitës të Bankës së Shqipërisë për futjen e instrumenteve të reja të pagesës në përdorim, me synim realizimin e objektivit strategjik të saj reduktimin e sasisë së *cash*-it në ekonomi.
3. Unifikimi i afateve të përpunimit të urdhërpagesave dhe çeqeve në sistemin bankar, i cili u konkludua në marrëveshjen ndërmjet bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë.
4. Automatizimi i kleringut si një nga tre elementet përbërëse të sistemit të pagesave, që lidhet direkt me klientët e bankave, individët e bizneset shqiptare. Bankat dhe Banka e Shqipërisë janë shprehur në favor të automatizimit të tij dhe të zhvillimit në formën e centralizuar.
5. Gjatë kësaj periudhe është punuar dhe në drejtim të përmirësimit të bazës ligjore për çekun. Është punuar për rishikimin e ligjit aktual "Për çekun" nga specialistët (juristë, ekonomistë) dhe puna për të po vazhdon në fazat e mëtejshme.
6. U hartua skema e re përcaktuese e KIB (kodit të identifikimit bankar).
7. Gjatë dhjetëmujorit u realizua një volum më i rritur pagesash:
  - u transferuan fonde midis bankave të nivelit të dytë për këtë periudhë me vlerë 40.764 milionë lekë, kundrejt 31.228 milionë lekëve të të njëjtës periudhë të vitit 1999 ose një rritje prej 30 për qind;
  - u kliruan urdhërpagesa dhe çeqe me vlerë 43.526 milionë lekë ose (mesatarisht në një ditë 207 milionë lekë) kundrejt 41.017 milionë lekëve të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Rritja kundrejt vitit të kaluar është 6,1 për qind. Për vitin 2000 peshën më të madhe, 51,3 për qind e zënë urdhërpagesat, si instrumenti i përdorur më gjerësisht në sistemin bankar kundrejt 50,6 për qind të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

#### **b. Kontabiliteti.**

Strategjia e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë e parë nga këndvështrimi i kontabilitetit, u konceptua në drejtim të realizimit të projektit mbi "**Modernizimin e sistemit kontabël në Bankën e Shqipërisë**".

Hapat që do të ndërmerreshin për realizimin e këtij projekti do të ishin:

- i. kontrolli i llogarive dhe dhënia e opinionit për pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 1999 nga kontrollorë të jashtëm



- me reputacion ndërkombëtar;
- ii. hartimi i Manualit Kontabël për Bankën e Shqipërisë sipas IAS;
- iii. informatizimi i plotë i sistemit kontabël.

**Projekti i parë.** *“Kontrolli i llogarive të vitit 1999 nga kontrollorë të jashtëm”.*

Ky projekt u realizua nëpërmjet auditimit të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë nga kompania Deloitte & Touche në periudhën 15 shkurt - 31 mars 2000.

**Projekti i dytë.** *“Hartimi i Manualit Kontabël për Bankën e Shqipërisë sipas (IAS)”.*

Ky projekt sipas rekomandimeve të FMN-së u realizua nga vetë stafi i Bankës së Shqipërisë. Drafti i manualit kontabël, ju dërgua paraprakisht për mendim Fondit Monetar Ndërkombëtar, Institutit të Ekspertëve Kontabël, Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe departamenteve të Bankës së Shqipërisë. Ekspertët e FMN-së dhanë opinion pozitiv duke e vlerësuar manualin kontabël si të plotë (gjithëpërfshirës) dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS).

Instituti i ekspertëve kontabël dha, gjithashtu, mendimet e tij ndërsa Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në mbledhjen e tij më datë 30.10.2000 diskutoi projektmanualin e Bankës së Shqipërisë dhe pritet që mendimet t'i japë brenda muajit nëntor. Në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 63, datë 05.07.2000 janë ngritur dhe miratuar grupet e punës me specialistë të departamenteve të Bankës së Shqipërisë për të studjuar mënyrën implementimit dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij manuali.

**Projekti i tretë.** *Informatizimi i plotë i sistemit kontabël.*

Për realizimin e këtij projekti është hartuar dokumenti “Mbi kërkesat e biznesit për informatizimin e plotë të kontabilitetit”. Ky projekt është në fazën e tenderimit për përzgjedhjen e këshilltarit për prokurimin e Sistemit Kontabël dhe të Pagesave.

Për periudhën e mbetur deri në fund të vitit:

- do të vazhdojë puna për miratimin e Manualit Kontabël të Bankës së Shqipërisë dhe për tenderimin për përzgjedhjen e auditorëve të huaj për kontrollin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2000;
- do të ndiqet projekti për Sistemin Kontabël dhe të Pagesave RTGS. Komisioni i vlerësimit do të përzgjedhë brenda muajit këshilltarin

e prokurimit të Sistemit Kontabël dhe të Pagesave RTGS.

## **12. Cili është kontributi i Bankës së Shqipërisë për përmirësimin e statistikave?**

Në konferencën për shtyp të datës 19 maj 2000, para medias u njoftua për përpjekjet e përbashkëta të Bankës së Shqipërisë dhe të INSTAT-it për organizimin e konferencës kombëtare “Informacioni statistikor në Shqipëri”.

Kjo konferencë u mbajt në datat 2-3 nëntor 2000 në Pallatin e Kongreseve.

Në përgjithësi, vlerësojmë se konferenca arriti qëllimin për të cilin ishte organizuar:

- Konferenca ishte e para e këtij lloji dhe tërhoqi vëmendjen për problemin e zhvillimit të statistikave.
- Konferenca ishte një shembull mjaft i mirë i bashkëpunimit midis dy institucioneve shqiptare dhe i produkteve mjaft të vlefshme, që mund të arrihen prej bashkëpunimit. Nëse do të më lejoni, do të shprehësja se ishte një konferencë e organizuar duke u mbështetur “në forcat tona”.
- Konferenca ngjalli interesin dhe siguroi mbështetjen nga autoritetet më të larta të Shtetit Shqiptar. Dua të falenderoj veçanërisht Presidentin e Republikës.
- Konferenca siguroi përgëzime nga përfaqësues të institucioneve të huaja si FMN, Federal Rezerva apo Eurostat, të cilët kontribuan mjaft me prezantimet e tyre.
- Konferenca rriti transparencën e Bankës së Shqipërisë dhe të INSTAT. Ajo u shndërrua në një forum, ku tepër sinqerisht, u trajtuan të gjitha problemet që na shqetësojnë sot në lidhje me zhvillimin e statistikave.
- Konferenca konkludoi edhe për çështjet më të rëndësishme, të cilat besohet se do të ndihmojnë në zhvillimin e statistikave.

Përfitojmë nga rasti të falenderojmë median për pasqyrimin korrekt, që i bëri këtij aktiviteti dhe ju ftoj që më tepër vëmendje e kujdes t'i kushtohet shifrave dhe të përpqemi “të kuptojmë gjuhën e tyre”.

Më poshtë, renditen edhe një herë propozimet më të rëndësishme të kësaj konference:



1. Të krijojmë një atmosferë pune dhe kërkimi ku informacioni statistikor të shihet si një investim që i shërben procesit të integritetit dhe stabilizimit rajonal të Shqipërisë.
2. Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues të kryhet në funksion të monitorimit të ndryshimeve socialekonomike të vendit, të forcimit dhe të pasurimit të bashkëpunimit institucional si dhe të detyrimeve, që rrjedhin prej tij, duke synuar rritjen e produktit statistikor.
3. Përditësimi i programit kombëtar statistikor nga INSTAT duhet të shihet si një objektiv afatshkurtër. Ai duhet të mbështetet në përcaktimin e detyrave konkrete të institucioneve të tjera shtetërore. INSTAT duhet të forcojë rolin e vet të udhëheqësit metodik dhe të prodhuesit, për çdo tregues që luan rolin e të dhënës kombëtare.
4. Sigurimi i mbështetjes së nevojshme financiare për INSTAT, për të mundësuar mbulimin më të mirë të nevojave, në ndërmarrjen e zgjerimit të numrit të treguesve, përmirësimin e cilësisë teknike të sistemeve të përpunimit të informacionit dhe një përhapje më të shpejtë dhe të automatizuar të informacioneve.
5. Forcimi i rolit të shërbimit statistikor në çdo institucion shtetëror, kërkon medoemos që sektori i statistikave, organizimi dhe funksionimi i tij të jenë në vëmendjen e drejtuesve të lartë të administratës shtetërore.
6. Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i përdoruesve të informacionit për të prezantuar drejt kërkesën e tyre dhe për të orientuar grumbullimin dhe prodhimin e të dhënave.
7. Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i furnitorëve të të dhënave dhe në veçanti të sektorit privat, për rolin që ato kanë në rritjen dhe në përmirësimin e cilësisë së informacionit statistikor. Pa rolin e tyre të drejtpërdrejtë në dhënien e informacionit statistikor me cilësi dhe në kohë, nuk mund të kemi statistika të mira e nuk mund të merren vendime të drejta që ndikojnë drejtpërdrejt edhe në aktivitetin biznesor të tyre.
8. Përdorimi i detyrueshëm i klasifikimeve kombëtare të miratuara nga Këshilli i Ministrave duhet të gjejë zbatim nga të gjithë aktorët e shërbimit statistikor kombëtar. INSTAT duhet të marrë përsipër rolin drejtues në përhapjen dhe në kontrollin e zbatimit të tyre.

9. Rritja e investimeve në fushën e teknologjisë së informacionit duhet të konsiderohet si një investim që bëhet për të rritur njohjen dhe përdorimin e informacionit statistikor dhe që u jep mundësi përdoruesve të brendshëm dhe të jashtëm të përdorin informacionin.
10. Për të ruajtur frymën e dialogut dhe të komunikimit ndërinstytucional, le ta quajmë këtë konferencë si momentin e themelimit të një forumi mbi statistikat, i cili herë pas here do të bëjë një ballafaqim të arritjeve sipas detyrave të nxjerra dhe do të japë rekomandime për përsosje të mëtejshme.

### **13. Cilat janë zhvillimet në fushën e emisionit të monedhës?**

**Si dhjetëmuor,** edhe në fushën e emisionit ka patur arritje në përmbushjen e detyrave të programuara. Kështu:

- \* ka një përgatitje dhe ambicje për emetime të monedhave përkujtimore. Janë hartuar programe e janë marrë vendime, që premtojnë realizime konkrete në vitin 2001;
- \* janë shënuar përmirësime në strukturën e monedhës shqiptare në qarkullim;
- \* është hedhur në qarkullim më 1 shtator 2000, si prerje e dubluar, monedha 100 lekëshe, e cila është mirëpritur në pozicionin e saj;
- \* është rritur monedha shqiptare në qarkullim për afro 12,9 miliardë lekë ose 15,5 për qind në krahasim me gjendjen e saj në fundvitin 1999;
- \* monedha në qarkullim, edhe pse e rritur në krahasim me nivelin e programuar, nuk ka cënuar objektivat e Bankës së Shqipërisë në treguesit monetarë.

#### **\* Marrëdhëniet me Publikun.**

Këto marrëdhënie, gjatë periudhës në fjalë, kanë regjistruar një kurbë rritjeje në sasi dhe në cilësi. Këtu duhet përmendur miratimi i rregullores për Transparencën dhe Konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë si dhe përmirësimi i teknologjisë së komunikimit elektronik si brenda ashtu edhe jashtë Bankës. Njoftime të tilla si, tematika dhe informacioni mbi zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës kryhen si përpara zhvillimit të këtyre mbledhjeve ashtu edhe pas përfundimit të tyre. Me to tashmë njihet i gjithë stafi i Bankës së Shqipërisë, media dhe institucionet qendrore qeveritare, bankat dhe të gjithë organizmat dhe subjektet e interesuara.





**Janë shtuar konferencat për shtyp të Guvernatorit dhe do të ketë shtim periodik të konferencave për shtyp edhe të Zëvendësguvernatorit të Parë dhe të deklaratave për shtyp nga departamentet kryesore .**

\* **Publikimet e Bankës së Shqipërisë.**

Prej rreth dy vjetësh Banka e Shqipërisë përgatit dhe shpërndan për publikun një seri të tërë botimesh periodike dhe joperiodike, me natyrë teknike dhe shpjeguese. Këto botime kanë ardhur duke u shtuar si në tituj, ashtu edhe në tirazh duke u përmirësuar nga ana pamore dhe nga brendia.

Mungesa e traditës dhe e të qenurit gjithmonë në kontakt të drejtpërdrejtë me vlerësimin e publikut të specializuar në këtë fushë, nuk tregoi të ishte pengesë në krijimin e emrit, të respektuar nga të gjithë, të Bankës së Shqipërisë në këtë impenjim të guximshëm të saj.

Një tregues, dukshëm i pamohueshëm, është shtimi i kërkesës për këto publikime, që vjen nga institucionet e ndryshme financiare, nga përdoruesit privatë brenda dhe jashtë vendit. Kështu, në qoftë se në numrat e parë shpërndaheshin rreth 100 kopje të secilit prej publikimeve, tani janë rreth 300 që shpërndahen.

Rezultat i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i Konferencës “Informacioni Statistikor në Shqipëri” ishte rritja e numrit të kërkuësve të botimeve të Bankës me 30 të rinj. Ky shtim ishte në mënyrë të njëjtë për të gjithë titujt dhe pothuaj për të dyja gjuhët. Nuk duhet neglizhuar fakti që shumica e pjesëmarrësve në konferencë ishin, që më parë, të përfshirë në këtë listë. E veçanta e të listuarve të rinj është që, në shumicën e tyre, i përkasin akademikëve, bibliotekave të fakulteteve, kërkuësve si edhe bizneseve private. Mendoj që ky është tregues, që vlen të komentohet. Më tepër se kaq, ai është një tregues i interesit, që po tregohet për opinionin e Bankës së Shqipërisë dhe të specialistëve të saj dhe i seriozitetit me të cilin prezantohet ky institucion.

Por, synimi i Bankës së Shqipërisë do të shkojë më tej. Përfitoj nga rasti t’u drejtohem gazetarëve të pranishëm në këtë konferencë dhe gazetarëve të tjerë që të trajtojnë po me seriozitet informacionin, që ata sigurojnë nëpërmjet këtyre botimeve. Nga ana e saj, Banka ka si objektiv që sa më shpejt të angazhohet edhe në aktivitetet e trajnimit të gazetarëve me çështje të fushës ekonomike.